



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 3263/6 Prot.

Koplik, më 12 / 12 /2025

V E N D I M

Nr. 51, datë 11.12.2025

Për

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës Financiare për familjen e Zonjës Festime Haki Kukaj banesa e te cilit është djegur nga zjarri

Këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe ne mbledhje e datës 11.12.2025 me propozim të kryetarit të Bashkisë, mbështetur ne Ligjin 139/2015“Per vetëqeverisjen vendore“, neni 54, shkronja“dh“,Ligjin 45 neni 30,41 pika 1,2,3, datë18.07.2019“Per Emërgjencat Civile“, VKM_së nr.329 date 16.05.2012 kreu III/I “Per kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësi natyrore ose fatëkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“,Udhëzimi i perbashkët i Ministrisë së Brendëshme dhe Ministrisë së Financave Nr.263,datë 224.05.2013 „Për kriteret dhe procedurat dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësi natyrore ose fatëkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, VKB Nr.81..date 31.12.2024 Per miratimin e buxhetit të Vitit 2025.

V E N D O S I:

1-Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për ndihmen e menjëherëshme financiare familjes së znj. **Festime Haki Kukaj** në vlerën **282,807,5** (dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatë, presje pesë) lekë, për djegjen e banesës së tij nga zjarri.

2-Burimi i financimit të jetë fondi i Emergjencave Civile parashikuar në Programin“**Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile**“, ne buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhë për **vitin 2025** të miratuar me VKB. .81..datë 31.12.2024 në programin_“Perballimi i ndihmave të menjëhershne për familjet në raste fatkeqesie“.

3-Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjorë të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për familjen e znj. **Festime Haki Kukaj** në vlerën e dëmit nga ana ndertimore në shumen **307.715**(treqind e shtatë mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) lekë, 50% i saj është **153.857,5** (njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë, presje pesë) lekë dhe elektroshtëpijake në shumen **257.900**(dyqind e pesëdhjete e shtatë mije e nenteqind) lekë,ku 50% i saj është **128.950** (njëqindtenjetezete tete mije e nenteqind qind e pesëdhjete) leke . Sipas preventivave te Komisionit të Vlerësimit të

dëmeve pranë Bashkisë Malësi e Madhe. Vlera totale e dëmeve është **565.615** (pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë) lekë ku 50% i saj është **282.807,5** (dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatë, presje pesë) lekë.

4- Ngarkohet administrata e Bashkisë Malësi e Madhe për likuidimin e shumës prej **282,807,5** (dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatë, presje pesë) lekë.

5- Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Finances dhe sektori i Emergjencave Civile.

6- Ky vendim hyne në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e ligjit Nr.139/2015 „ Per veteqeverisjen vendore“

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 11.12.2025

Vota Pro 19

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me date 12.12.2025

